

REPF i azhurnuar dhe përmirësimet e planifikuara

04/06/2019

Ranjan Ganguli, SNKSP Konsulent (ranjan@ganguli.co.uk)



CFRR»
Centre for Financial
Reporting Reform



Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO



REPF është:
Raporti për përmirësim të raportimit
financiar në sektorin publik

Prapavija dhe qëllimi i REPF



3

- Raporti i përmirësimit të raportimit financiar në sektorin publik (REPF) është zhvilluar nga Regjioni European dhe i Azisë qendrore i Bankës Botërore bazuar në punën në Azerbaixhan në vitin 2004;
- Qëllimi i REPF është të vlerësohet korniza e raportimit financiar e sektorit publik dhe në përgjithësi të ndihmojë përgatitjen e tranzicionit në standardet e kontabilitetit të sektorit publik;
- Përgatitja për kalim në kontabilitetin akrual kërkon një kuptim të mjedisit të kontabilitetit të sektorit publik. Gjithashtu kërkon kuptim të zbrastësirës në mes të standardeve aktuale të kontabilitetit dhe kontabilitetit akrual bazuar në standardet siq janë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP).
- REPF mundëson një mbledhje sistemike të informatave për kornizën specifike të raportimit financiar që përbëhet nga:
 - i. informacion mbi mjedisin e kontabilitetit të sektorit publik; dhe
 - ii. një vlerësim të hendekut midis standardeve të kontabilitetit të sektorit publik të vendit dhe SNKSP

Struktura e REPF



4


- Pjesa 1 – Vlerësimi i mjedisit kontabilitetit të sektorit publik
- Part 2 – Vlerësimi i standardeve të kontabilitetit të sektorit publik siç janë projektuar
- Part 3 - Vlerësimi i praktikave të kontabilitetit
- Part 4 – Vlerësimi i vlerës së shtuar pas miratimit të SNKSP.

Struktura e REPF

Pjesa 1 – Vlerësimi i mjedisit kontabilitetit të sektorit publik



5



Struktura e REPF

Part 2 – Vlerësimi i standardeve të kontabilitetit të sektorit publik siç janë projektuar



6



Struktura e REPF

Part 2 – Vlerësimi i standardeve të kontabilitetit të sektorit publik siç janë projektuar



7

- Fushat e standardeve të sektorit publik që janë më në përputhje me SNKSP
- Fushat e standardeve të sektorit publik që janë më pak në përputhje me SNKSP
- SNKSP në të cilën standardet kombëtare të sektorit publik janë krejtësisht të heshtura


Struktura e REPF

Part 3 - Vlerësimi i praktikave të kontabilitetit



8





Vërejtje – Kufizimet e REPF



10

- Një REPF mund të informojë hartimin e çdo programi të ardhshëm të reformës së kontabilitetit në sektorin publik. Elementet e një vlerësimi të REPF janë të nevojshme për të informuar projektin, por në vetvete janë të pamjaftueshme. **Ju nuk mund të krijoni një program të plotë të reformës së kontabilitetit në sektorin publik bazuar vetëm në rezultatet e një REPF!**
- Një shënim teknik i FMN 2016 bën të qartë se përgatitja zakonisht do të përfshijë detyrat e mëposhtme paraprahe, asnjëra prej të cilave nuk adresohet ose vlerësohet në një FPP:
 - ☐ Sqaroni objektivat e reformës
 - ☐ Themelimi i një ekipi reformues përfaqësues
 - ☐ Vlerësoni shpenzimet e reformës
 - ☐ Krijoni një mekanizëm për përcaktimin e standardeve të kontabilitetit
 - ☐ Trajnimi dhe menaxhimi i ndryshimeve
 - ☐ Zhvillimi i një plani veprimi për tranzicionin

Arkitektura e reformës së PULSAR




11

<https://www.pulsarprogram.org/>

[Roadmap to Public Sector Accounting
Reform: Good Practice Template](#)

https://www.pulsarprogram.org/sites/pulsar/files/libdocs/PSA_Reform_Roadmap.pdf

Figure 1: Reform Architecture



Aplikimi i REPF



12

- Shqipëria
- Azerbaixhan
- Gjeorgjia
- Republika e Kirgistanit
- Polonia
- Serbia
- Ukraina



REPF Shqipëria – Maj 2017

Qëllimi i këtij raporti ishte të mbështeste zhvillimin e një plani për të bërë një kalim në kontabilitetin akrual në përputhje me SNKSP. Raporti vlerësoi kornizën institucionale për kontabilitetin e sektorit publik si dhe hendekun midis GAAP Sektorit Publik dhe SNKSP. Raporti përmban rekomandime për të fuqizuar kornziën dhe GAAP.

REPF Shqipëria– Korniza Institutionale



- Informata të pasakta në lidhje me numrat dhe përbërjen e entiteteve e sektorit publik
 - Korniza ligjore e fragmentuar dhe komplekse
 - Numër i ulët i stafit financiar – rreth 3,000 persona që shërbejnë në 1,300 entitete
 - Universitetet kanë mbulesë të ulët të politikave kontabël të sektorit publik. Nuk ka kualifikime profesionale për sektorin publik apo organizatë profesionale. Nuk ka trajnim të rregullt për ZHVP për stafin e financave të sektorit publik.
 - MF përgjegjëse për përcaktimin e PPPK por nuk ka procedura të themeluara për përgatitjen dhe për diskutim të gjërë. Nuk ka kod të etikës.
- Implementimi i raporteve buxhetore janë në fakt një produkt i PPPK të sektorit publik të Shqipërisë. Vetëm raportet buxhetore janë publikuar. GFS dhe raportimi i Eurostat do të përfitojë nga të dhënat më të mira akruale
 - AGFIS TI sistemet janë duke u zhvilluar më tutje dhe janë duke u shpërndarë në sektorin publik. Në ndërkohë entitetet e sektorit publik përdorin sistemet vendore të TI për të kompenzuar mungesën e funksionalitetit. Është me rëndësi kritike fakti që AGFIS është plotësisht ne funksion dhe përdoret nga të gjitha entitetet e qeverisë.

REPF Shqipëria– Krahاسimi i GAAP të SP në Shqipëri me SNKSP



● Lista e SNKSP konsistente me PPPK në Shqipëri:

- SNKSP 1 - Prezantimi (megjithëse nuk ka shpalosje të rreziqeve kryesore)
- SNKSP 4 - Efektet e ndryshimeve në këmbimin valutor
- SNKSP 17 - Pasuritë, impiantet dhe pajisjet (edhe pse amortizimi ngarkohet direkt dhe pa rishikim periodik të vlerës së mbetur)
- SNKSP 23 - Të ardhurat nga transaksionet pa këmbim, tatimet dhe transferet (edhe pse të ardhurat njihen në bazë të parasë së gatshme dhe grantet e investimeve njihen drejtpërdrejt në ekuitet)

● Lista e SNKSP me pak konsistente me PKKK në Shqipëri:

- SNKSP 2 - Pasqyra e rrjedhës së parasë. Klasifikime të ndryshme.
- SNKSP 5 - Shpenzimet e huamarrjes. Baza e parasë së gatshme.
- SNKSP 14 - Ngjarje pas datës së raportimit. Ngjarjet e rregulluara dhe jo të rregulluara që nuk merren parasysh.
- SNKSP 31 - Aktivitetet e paprekshme. Përkufizimi themelor i shpenzimit i papajtueshëm me SNKSP 31.
- PKKK shqiptare e heshtur lidhur me SNKSP: 13, 16, 18, 19, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 32, 34, 36, 37, 38 dhe 39.

REPF Shqipëria– Rekomandimet për Strategjinë e implementimit të SNKSP



- Miratimi i pjesshëm i SNKSP. PPPK do të modifikohen në mënyrë të tillë që të jenë në përputhje me pjesë të përzgjedhura të disa prej SNKSP. Pjesët e ndryshme të çdo kërkesë të re në PPPK do të specifikoheshin si efektive në data të ndryshme në mënyrë që të lejohet zbatimi në fazë, sidomos duke njohur çështjet e: financimit të reformës; përshtatjen dhe përmirësimin e AGFIS si dhe të sistemeve të tjera kontabël; edukimin, trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve; dhe menaxhimin e lidhjeve me reformat e tjera të vazhdueshme të Menaxhimit të Financave Publike.
- Krijimi i kërkesës për reforma të kontabilitetit të sektorit publik
- Adresimi ndaj kuadrit institucional
- Përkthimi i SNKSP përkatëse në gjuhën shqipe
- Zbatimi i plotë i reformave kryesore të MFP-së - Regjistri i pasurive fikse. Lansimi i AGFIS në internet. Zbatimi i plotë i AGFIS. Sistemi i centralizuar i pagave. Sistemi për të monitoruar borxhet. Zbatimi i AFMIS
- Zbatimi i aspekteve të zgjedhura të SNKSP: 5, 14, 23, 17 dhe 2

REPF Shqipëria– Konkludimet nga punëtorja e REPF për implementimin e strategjisë së SNKSP



- Rivendosni si masë kalimtare grupin e ligjeve të kontabilitetit dhe udhëzimeve që janë në fuqi
 - Përcaktimi dhe identifikimi i subjekteve të kontrolluara dhe caktimi i palës përgjegjëse për mbajtjen e kësaj liste
 - Një qasje e zbatimit në faza do të ndiqet për zbatimin e një strategjie të kontrolluar dhe efektive
- AGFIS: Strategjia e zbatimit të SNKSP është e nevojshme për të konfiguruar siç duhet AGFIS, megjithatë disa aktivitete mund të fillojnë para fillimit të plotë të AGFIS duke përfshirë zhvillimin e kuadrit të ri ligjor, përkthimin e SNKSP dhe disa aktivitete trajnuese.
 - Do të formohet Ekipi i Zbatimit të Projektit i cili do të përfshijë aktorët kryesorë, duke përfshirë Departamentet e Thesarit dhe Buxhetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe përdoruesit



E ardhmja e REPF

E ardhmja e REPF



19

- Zhvillimi i një metodologjie të harmonizuar dhe përgjithësisht të pajtuar për të vlerësuar kuadrin e raportimit financiar të një sektori publik të një vendi, gjegjësisht marrjen e përvojave nga rajone të tjera të Bankës Botërore si dhe institucioneve të tjera të zhvillimit;
- Miratimi i qasjes së përdorur nga PEFA dhe gjithashtu lidhja e rezultateve të një REPF me treguesit përkatës PEFA.
 - PEFA është një mjet i përdorur gjerësisht dhe shumë i çmuar për të vlerësuar statusin e menaxhimit publik financiar të një vendi (MFP). Ai siguron një analizë të qëndrueshme dhe bazuar në dëshmi të performancës së MFP në një pikë specifike në kohë dhe mund të ripërdoret në vlerësimet e njëpasnjëshme për të ndjekur ndryshimet me kalimin e kohës.
 - Zhvillimi i indikatorëve të performancës së REPF bazuar në dëshmi dhe dimensionet e ndara sipas një vlerësimi të hollësishëm të kornizës së raportimit financiar të sektorit publik të një vendi
 - Të sigurohet se treguesit e performancës së REPF si dhe të dhëna të tjera të mbledhura gjatë një vlerësimi të REPF mund të përdoren drejtpërdrejt në një vlerësim të PEFA duke përfshirë treguesit dhe dimensionet e performancës



Falemnderit.
Pyetje?